VENDIM
Nr. 116, datë 13.3.2019

PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS PRANË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME DHE TË NJËSISË PRANË MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE NË VJENË, PËRGJEGJËSE PËR KRYESIMIN E GRUPIT TË KONTAKTIT TË MESDHEUT, ORGANIZATËS PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË DHE GRUPIT TË KONTAKTIT PËR AZINË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të ligjit nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", dhe të nenit 11, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit dhe ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TASK-FORCA NË MINISTRINË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

1. Në varësi të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme ngrihet Task-Forca, si institucion përgjegjës për kryesimin e:

a) Grupit të Kontaktit të Mesdheut (më poshtë referuar GKM), në kuadrin e OSBE-së, në vitin 2019;

b) Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (më poshtë referuar OSBE), në vitin 2020;

c) Grupit të Kontaktit për Azinë (më poshtë referuar GKA), në kuadrin e OSBE-së, në vitin 2021.

2. Task-Forca, e krijuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, ka si qëllim arritjen e këtyre objektivave:

a) Drejtimin me sukses të gjithë procesit të kryesimit të OSBE-së, GKM-së dhe GKA-së në periudhat e përcaktuara në pikën 1;

b) Drejtimin, në emër të Kryetarit të Radhës, të gjithë veprimtarisë së kryesimit të OSBE-së, nëpërmjet koordinimit të punës me Misionin e Republikës së Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare dhe ON në Vjenë;

c) Mbështetjen e përfaqësimit të Republikës së Shqipërisë si Kryetare e Radhës në OSBE;

ç) Mbikëqyrjen e aktiviteteve të OSBE-së, që lidhen me parandalimin e konflikteve, administrimin e krizave dhe të situatave postkonflikt në hapësirën e OSBE-së;

d) Drejtimin dhe koordinimin e punës ndërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme (më poshtë MEPJ), institucionit të Presidentit të Republikës, Kuvendit dhe institucioneve të administratës shtetërore shqiptare për periudhën e kryesimit të OSBE-së, GKM-së dhe GKA-së;

dh) Hartimin dhe propozimin për miratim ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme të prioriteteve dhe qëndrimeve të kryesimit të OSBE-së, GKM-së dhe GKA-së;

e) Evidentimin dhe përçimin e vlerave më të mira të politikës së jashtme të Republikës së Shqipërisë në ruajtjen dhe forcimin e paqes e të sigurisë, nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet vendeve dhe popujve në rajonet ku vepron OSBE-ja, në mbrojtje dhe respektim të të drejtave të njeriut.

3. Për realizimin e objektivave, sipas pikës 2, të këtij vendimi, Task-Forca kryen këto detyra:

a) Ndjek të gjitha zhvillimet që kanë të bëjnë me çështje të sigurisë, bashkëpunimit dhe ato të respektimit të të drejtave të njeriut në rajonin e OSBE-së dhe më gjerë;

b) Së bashku me Misionin e Republikës së Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare në Vjenë, angazhohet për organizimin e aktiviteteve në përputhje me prioritetet e kryesisë në tri dimensionet e OSBE-së;

c) Përgatit dhe koordinon aktivitetet që parashikon programi i kryesimit të OSBE-së;

ç) Përgatit programin e punës dhe prioritetet për kryesimin në GKM dhe GKA;

d) Në bashkëpunim me strukturat e MEPJ-së dhe ministritë e linjës, përgatit qëndrimet përkatëse për zhvillimet gjatë kryesimit të OSBE-së, GKM-së, GKA-së;

dh) Organizon agjendën e Kryetarit të Radhës së OSBE-së, ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, në funksion të vizibilitetit të nevojshëm dhe situatave të krijuara;

e) Organizon konferencën mesdhetare, takimin e ministrave të jashtëm të shteteve anëtare të OSBE-së në Tiranë dhe Konferencën Aziatike;

ë) Kryeson, bashkërendon dhe raporton mbi aktivitetet e saj në takimet e Këshillit të Ministrave, Këshillit të Përhershëm dhe organeve të varësisë të OSBE-së;

f) Bashkëpunon me Sekretariatin e OSBE-së, institucionet dhe misionet e organizatës në terren për zbatimin e prioriteteve të Kryesisë.

4. Task-Forca varet nga ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe, në mungesë të tij, nga njëri prej zëvendësministrave, dhe në përbërje ka:

a) diplomatë karriere;

b) nëpunës të emëruar nga ministritë e tjera;

c) ekspertë të jashtëm;

ç) nëpunës financierë dhe juristë;

d) personel teknik dhe mbështetës.

5. Task-Forca informon në vijimësi titullarin e MEPJ-së dhe, me miratimin e tij, institucionet qendrore shqiptare për çështje me rëndësi që dalin nga drejtimi i OSBE-së.

6. Trajtimi financiar për personelin e Task-Forcës është, si më poshtë vijon:

a) Diplomatët e karrierës trajtohen sipas pagës referuese të gradës diplomatike personale ose në përputhje me pozicionin e emërimit;

b) Nëpunësit e emëruar nga ministritë e tjera trajtohen sipas pagës për pozicionin e punës që mbulojnë në institucionet respektive;

c) Pagesa për ekspertët e jashtëm barazohet me pagën e nëpunësit civil të kategorisë III b;

ç) Pagesa për nëpunësit "financierë/juristë" barazohet me pagën e nëpunësit civil të kategorisë III b;

d) Pagesa për personelin teknik dhe mbështetës trajtohet sipas pagës referuese për pozicionin shofer dhe sekretar, të përcaktuar në vendimin nr. 717, datë 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar.

7. Struktura e Task-Forcës përcaktohet me urdhër të Kryeministrit.

II. NJËSIA PRANË MISIONIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PRANË ORGANIZATAVE NDËRKOMBËTARE NË VJENË

1. Pranë Misionit të Republikës së Shqipërisë pranë Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë krijohet njësia përgjegjëse (më poshtë Njësia) për mbulimin e kryesimit të:

a) Grupit të Kontaktit të Mesdheut (GKM), në vitin 2019;

b) Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), në vitin 2020; dhe

c) Grupit të Kontaktit për Azinë (GKA), në vitin 2021.

2. Njësia është përgjegjëse për mbulimin e të gjitha angazhimeve që rrjedhin për Misionin e Republikës së Shqipërisë pranë Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë nga kryesimi i GKM-së, OSBE-së dhe GKA-së.

3. Njësia është në varësi të Përfaqësuesit të Përhershëm të Republikës së Shqipërisë pranë Organizatave Ndërkombëtare në Vjenë dhe ka në përbërje të saj:

a) diplomatë;

b) nëpunës të emëruar nga ministritë e tjera;

c) ekspertë të huaj të sekonduar;

ç) ekspertë të huaj të kontraktuar;

d) personel teknik dhe mbështetës.

4. Trajtimi financiar për personelin e Njësisë është, si më poshtë vijon:

a) Diplomatët trajtohen sipas pagës referuese të gradës diplomatike të emërimit, në përputhje me vendimin nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e pagave dhe shtesave mbi pagë të punonjësve të përfaqësive diplomatike të Republikës së Shqipërisë në shtetet e huaja, të atasheve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe personelit civil të Ministrisë së Mbrojtjes, që shërbejnë në përfaqësitë ushtarake të Republikës së Shqipërisë pranë NATO-s, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si nëpunës ndërlidhës pranë qendrës SECI, të punonjësve shqiptarë për kohën që shërbejnë si oficerë kontakti, pranë ministrive të brendshme homologe të shteteve të ndryshme të atashuar në përfaqësitë diplomatike të Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar, dhe vendimin nr. 20, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për mbulimin e shpenzimeve financiare të personelit të shërbimit të jashtëm dhe familjarëve që i shoqërojnë ata gjatë kohës që dërgohen me shërbim në misionet diplomatike dhe postet konsullore të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit";

b) Nëpunësit, të cilët përfaqësojnë ministritë e linjës, trajtohen nga institucionet respektive, sipas pagës referuese të gradës diplomatike të emërimit "Sekretar i Parë", në përputhje me vendimin nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, dhe vendimin nr. 20, datë 18.1.2017, të Këshillit të Ministrave;

c) Ekspertët e huaj të sekonduar trajtohen financiarisht tërësisht nga vendet sekonduese;

ç) Ekspertët e huaj të kontraktuar trajtohen nga buxheti i MEPJ-së, sipas kontratave tip të OSBE-së;

d) Personeli teknik dhe mbështetës trajtohet nga buxheti i MEPJ-së, sipas pagës referuese për pozicionin e punës, në përputhje me vendimin nr. 546, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave.

5. Personeli sipas shkronja "b", të pikës 3, të kreut II, për periudhën e shërbimit në Mision gëzon statusin e diplomatit, në përputhje me ligjin nr. 23/2015, "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë", por nuk përfiton gradë diplomatike personale.

6. Struktura e Njësisë përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

III. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nëpunësit e Task-Forcës dhe të Njësisë emërohen dhe lirohen nga ministri përgjegjës për punët e jashtme, sipas dispozitave të ligjit nr. 23/2015 "Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë".

2. Përshkrimi i punës dhe detyrat kryesore të secilit punonjës të Task-Forcës e Njësisë përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për punët e jashtme.

3. Strukturat e MEPJ-së dhe të institucioneve të përfaqësuara në përbërje të Task-Forcës dhe Njësisë mbështesin me informacion dhe materiale aktivitetin e tyre.

4. Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme i shtohen 14 punonjës për Task-Forcën dhe Njësinë e Misionit në Vjenë, duke e çuar numrin e përgjithshëm të punonjësve të ministrisë në 565 punonjës. Ky numër përballohet nga reduktimi në të njëjtën masë i numrit rezervë të punonjësve për vitin 2019.

5. Efektet financiare për ushtrimin e veprimtarisë së Task-Forcës dhe të Njësisë të përballohen nga buxheti i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe i institucioneve pjesëmarrëse në to, miratuar, respektivisht, për vitet 2019, 2020 e 2021, si dhe nga burime financiare e materiale të siguruara për këtë qëllim në mënyra të ligjshme nga institucione vendase ose të huaja.

6. Ngarkohet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të gjitha institucionet shtetërore, brenda fushës së tyre të përgjegjësisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama